


UNIVERSITETI I PRISHTINËS – REKTORAT

Shërbimi Financiar

Struktura organizative





Detyrat dhe obligimet e Shërbimit Financiar janë:

- Përcaktimi i strategjisë zhvillimore dhe buxhetimi,
- Barazimi dhe raportimi i të hyrave,
- Procesimi, aprovimi dhe raportimi i shpenzimeve,
- Menaxhimi i pasurisë fizike dhe materialet hargjuese,
- Menaxhimi i parave te gatshme dhe parave te imta,
- Krijimi dhe zhvillimi i dokumentacionit,
- Ruajtja dhe sistemimi i dokumentacionit dhe
- Raportet, analizat dhe pasqyrat financiare.

Shërbimi Financiar, me rregull mban takime ditore, ku bashkëpunojnë: Udhëheqësi i shërbimit – Prorektori për burime dhe infrastrukturë, me drejtorin dhe me zyrtarët e shërbimit.


Në mënyrë që të hyrat e Universitetit (si ato nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, e poashtu edhe nga të hyrat vetanake) të shfrytëzohen në mënyrë sa më efikase.

Shërbimi Financiar për vitin 2008 ka arritë të prezantojë nevojat për shpenzime kapitale, paga, shpenzime dhe mallra. Kjo është arritë duke thellua bashkëpunimin me njësitë akademike dhe përforcimeve kadrovike që janë rezultat i zgjedhjeve në Universitet.

Buxheti i Universitetit të Prishtinës

Burimet kryesore të buxhetit për Universitetin janë:

- Buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe
- Të hyrat vetanake – pagesat e studentëve.



Buxheti i konsoliduar i Kosovës

Planifikimi i buxhetit për mjetet e grantit qeveritar bëhet sipas qarkores së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila miratohet çdo vit.

Mjetet, të cilat janë të ndara nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, janë mjete të planifikuara nga Universiteti, të cilat shërbejnë për pagat e personelit dhe realizimin e objektivave të vitit përkatës. Këto mjete janë të destinuara për këto qëllime:

- Paga dhe mëditje,
- Mallra dhe shërbime,
- Shpenzime komunale dhe
- Shpenzime kapitale.

Pagesa e pagave tek ne bëhet përmes sistemit të Ministrisë së Shërbimeve Publike.



Të hyrat vetanake

Në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë për Ekonomi dhe Financa dhe Universitetit të Prishtinës janë të përcaktuara burimet e të hyrave vetanake dhe shpenzimet e tyre.

Në fondin e të hyrave vetanake në këtë vit kemi pas derdhje mjetesh edhe nga burimet tjera vetanake, si nga:

- Instituti i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike (grumbullimi i mjeteve në bazë të punës së tyre – me atestet e automjeteve) dhe
- Institutit të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (grumbullimi i mjeteve nga ekzaminimi i asfaltit),

të cilat janë menaxhuar me sukses.

Tatimet dhe kontributet

Sa u përket tatimeve dhe kontributeve, të punësuarit në Universitetin e Prishtinës, në çdo kohë mund të informohen për pagesat e tyre.

Kontakti:

Tel: 038 247 069 /071

Fax: 038 247 073

Të punësuarit e Universitetit, të cilët kanë paqartësi rreth pagave, mund të konsultohen dhe të informohen në shërbimin e financave të fakultetit përkatës.